



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 437/4 Prot.

Tiranë, më 12.09.2023

**V E N D I M**

**Nr. 181, Datë 12.09.2023**

Bazuar në ligjin Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O N:**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar ankesën Nr. 145 regj, datë 20.09.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së bashku”, kundër Postës Shqiptare sh.a., me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuar, që përfitojnë shërbimin në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a, në Njësinë Administrative nr.7, Bashkia Tiranë. Me vendimin nr.42, datë 27.03.2023, Komisioneri ka disponuar në lidhje me çështjen, duke vendosur:

1. *Konstatimin e diskriminimit në formën e rëndë të tij, të personave me aftësi të kufizuar, nga ana e Postës Shqiptare sh.a, në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga ana e saj pranë Zyrës Postare Tirana 21.*
2. *Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a, të marrë masa të menjëhershme për:*
  - a. *Plotësimin e të gjitha standardeve të aksesueshmërisë në Zyrën Postare Tirana 21, sipas parashikimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” dhe nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.*
  - b. *Hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

- aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.*
- c. Trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë, për të gjitha strukturat e saj.*
  - 3. Komisioneri i rekomandon Postës Shqiptare sh.a që marrja e masave të realizohet në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuar, të cilat janë njohës të nevojave të personave me aftësi të kufizuara.*
  - 4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Posta Shqiptare sh.a., detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.*
  - 5. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.*
  - 6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e dëgjimit.*

Rezultoni e provuar nga lajmërimi marrja e shërbimit postar se, Posta Shqiptare sh.a ka marrë dëgjimit për vendimin në datën 04.04.2023.

Bazuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se : “11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.”

Me shkresën nr.664/1 prot, datë 19.04.2023, Posta Shqiptare sh.a ka kthyer përgjigje mbi vendimin nr.42, datë 27.03.2023, duke informuar Komisionerin si vijon: “1. Posta Shqiptare sh.a funksionon si Shoqëri aksionere dhe duke funksionuar si e tillë ka hartuar Projekt-Programin e Zhvillimit të Shoqërisë për vitin 2023 dhe jemi në pritje të miratimit të këtij programi nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë e Shqipërisë dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Shqipërisë. 2. Me miratimin e Projekt-Programit të Zhvillimit të Shoqërisë për vitin 2023 do të vihen në dispozicion fonde për ndërtimin e një rampe në këtë zyrë postare brenda një periudhe sa më të shkurtër që të garantohen standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar”.

Nëpërmjet shkresës nr.437/3 prot, datë 08.05.2023, Komisioneri kërkoi nga Posta Shqiptare sh.a, që të vendoste në dispozicion:

- Pjesë nga dokumenti i Projekt-Programit të Zhvillimit të Shoqërisë për vitin 2023, ku janë parashikuar fondet dhe afatet përkatëse për sigurimin e aksesueshmërisë së zyrës postare objekt i vendimit.

- Informacion mbi procedurën dhe afatet se kur pritet të miratohet Projekt-Programi i Zhvillimit të Shoqërisë për vitin 2023.

Nëpërmjet shkresës së sipërcituar, Komisioneri solli në vëmendje të Postës Shqiptare sh.a, se, detyrimi ligjor dhe vendimi nr.42, datë 27.03.2023, kërkojnë marrjen e masave për të garantuar të gjitha standardet dhe kriteret teknike të aksesueshmërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këtë kuptim, rikonstruksioni i zyrës postare nuk duhet të adresojë vetëm ndërtimin e një rampe, por duhet të parashikohen dhe të sigurohen të gjitha aspektet e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Posta Shqiptare sh.a, nuk depozitoi pranë Komisionerit informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet shkresës nr.437/3 prot, datë 08.05.2023, në mënyrë që Komisioneri të vlerësonte në mënyrë reale masat për zbatimin e vendimit nr. 42, datë 27.03.2023. Posta Shqiptare sh.a, nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion në lidhje me masat e marra në zbatim pikës 2, gërmat “b” dhe “c”, të vendimit nr.42, datë 27.03.2023, në lidhje me hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit, për të cilat nevojitet përshtatshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, në ofrimin e shërbimeve dhe trajnimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë.

Rezultoi e provuar se, Posta Shqiptare sh.a, në cilësinë e subjektit të gjetur përgjegjës për sjelljen diskriminuese, nuk ka marrë masa për zbatimin e vendimit nr.42, datë 27.03.2023, të Komisionerit. Në këtë mënyrë, Posta Shqiptare sh.a, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33, pika 13, të ligjit të sipërpërmendur, shoqërohet me marrjen e masave administrative, gjobë. Për personat juridik, siç është në rastin konkret Posta Shqiptare sh.a, ky nen përcakton shkrehimisht: “*Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë*”:..... b) *personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....*”

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Posta Shqiptare sh.a është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 33, pika 11, të Ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, shkelje e cila sipas nenit 33, pika 13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të Ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku sanksionohet se: “*12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja*

*kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”*

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës dhe bazuar në: faktin që, shkelja e konstatuar prek një komunitet personash; faktin që, personat me aftësi të kufizuar të cilët diskriminohen nga shkelja e konstatuar, janë një komunitet vulnerabël; faktin që, Posta Shqiptare sh.a është përsëritëse në konsumimin e shkeljeve të së njëjtës natyrë, në disa raste; faktin që, Posta Shqiptare sh.a, është ndëshkuar edhe më parë me gjobë për moszbatimin e vendimeve të Komisionerit në lidhje me konstatime të të njëjtës natyre; Komisioneri, arrin në përfundimin se, Posta Shqiptare sh.a duhet të gjobitet me 200 000 (dyqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr.42, datë 27.03.2023.

Në nenin 33, pika 13, germa “d”, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, sanksionohet se: “13. Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë:..... d) personi fizik ose juridik, i cili kryen një ose më shumë nga format e rënda të diskriminimit, dyfishin e masës së gjobës së parashikuar përkatësisht në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 13, të nenit 33.”.

Në kushtet kur, me vendimin nr.42, datë 27.03.2023, Komisioneri ka konstatuar se, Posta Shqiptare sh.a ka kryer diskriminim në formën e rëndë të tij, si dhe në zbatim të parashikimit ligjor që bëhet nga neni 33, pika 13, germa “d” të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, gjoba në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë e aplikuar në zbatim të nenit 33, pika 13, germa “b” duhet të dyfishohet dhe Posta Shqiptare sh.a përfundimisht duhet të gjobitet me 400 000 (katërqind mijë) lekë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ç”, nenin 33, pika 11, 12 dhe 13, gjerat “b” dhe “d”, si dhe nenin 33/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Posta Shqiptare sh.a, të gjobitet në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë, për moszbatimin e vendimit nr.42, datë 27.03.2023 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Gjoba të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 ( dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijani.

3. Pagesa e gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 001, Distrikti (TDO) 3535, Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Zbatimi i vendimit nr.42, datë 27.03.2023, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sjell shfuqizimin e gjobës.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**